

Zyra e Koordinim-Zhvillimit

Zyra e Koordinim-Zhvillimit në Bashkinë Maliq është ajo pjesë e strukturës administrative të bashkisë që bën grumbullimin, sistemimin, selektimin, kompjuterizimin dhe analizën e të dhënave sipas sektorëve kryesorë të zhvillimit social-ekonomik të bashkisë , përgatit projekt-ide dhe projekt-propozime .

Gjithashtu merret me koordinimin e takimeve, aktiviteteve dhe ngjarjeve në bashki.

Bashkëpunon me Organizatat Jo-Fitimprurëse (OJF) Si dhe harton programe që sjellin projekte të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve nga pushteti lokal ndaj qytetarëve .

Bashkëpunon me komunitetin rom dhe egjiptian për të ndërrmarë iniciativa të përbashkëta për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Bashkëpunon me pallatin e kulturës “Dhimitër Orgocka” , për përgatitjen dhe zhvillimin e eventeve kulturore dhe artistike.

Të gjitha këto të ndërthurura së bashku , synojnë një zhvillim, një vizion për të ardhmen në Bashkinë Maliq.